



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr. 1;

E-mail: klsh.org.al; web-site: www.klsh.org.al

Nr. Prot.

Tiranë, më / /2018

V E N D I M

Nr. 165, Datë / / 2018

PËR
AUDITIMIN E USHTRUAR
NË GJYKATËN KUSHTETUESE, MBI "AUDITIMIN E PASQYRAVE
FINANCIARE".

Nga auditimi i ushtruar në Gjykatën Kushtetuese, me objekt "*Auditimin e pasqyrave financiare*", për periudhën 01.01.2017 deri në 31.08.2018, mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare, shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, nuk u konstatuan devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësisë materiale për të cilën japim *opinion të pakualifikuar*¹.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*",

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "*Mbi auditimin e pasqyrave financiare*", të ushtruar në Gjykatën Kushtetuese, Tiranë sipas programit të auditimit nr. 1122/1, dt. 08.10.2018 për veprimtarinë nga data 01.01.2017 deri 31.10.2018 .

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

¹ **Opinion i pakualifikuar.** - Jepet në rastet kur në opinionin e audituesit veprimtaria e subjektit përputhet në çdo aspekt material me kriteret e vlerësimit, sa i takon zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe akteve nënligjore që rregullojnë këtë veprimtari.

A. OPINIONI I AUDITUESIT:

Opinion i pakualifikuar :

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Gjykatës Kushtetuese për vitin ushtrimor, përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e gjendjes ekonomike, pozicionit financiar (*hyrjeve dhe daljeve*) (*pagesave*) në para, pasqyrën e amortizimit, pasqyrën e krahasimit të fondeve buxhetore dhe rezultateve aktuale, shënimet shpjeguese që shoqëronin këto pasqyra. Opinionin e dhënë e mbështesim në konstatimet se; bilancet, deklaratat e të ardhurave, deklaratat e mbajtjes së të ardhurave, banka, janë përfshirë në deklaratat financiare. Janë marrë evidenca të mjaftueshme që të mund të japim një opinion. Deklaratat financiare janë paraqitur sipas ligjit të kontabilitetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

Sipas opinionit të KLSH-së, mbështetur në standardet ISSAI 1700¹, dhe ISSAI 1200², pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të Gjykatës Kushtetuese në datën 31 dhjetor 2017.

B. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Nuk është hartuar dhe propozuar tek nëpunësi autorizues i njësive publike plani strategjik për periudhën objekt auditimi pra praktikisht planin strategjik 2017-2019 si dhe planin strategjik 2018-2020, i cili përmban objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit, të cilat janë në zbatim të strategjisë ndërsektoriale.

Rekomandojmë:

Gjykata Kushtetuese të marrë masa në krijimin e Planit Strategjik i cili duhet të përmbajë objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit, për arritjen e qëllimeve strategjike, me persona konkretë përgjegjës për realizimin e tyre. Objektivat strategjike duhet të jenë të lidhura me planin financiar buxhetor përmes objektivave të përcaktuara në mënyrë të qartë për programet, projektet dhe aktivitetet.

Në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi: Gjykata Kushtetuese edhe pse gjatë periudhës së auditimit ka pasur ndryshime në struktura si pozicione të reja apo sektorë të ndryshëm, institucioni vazhdon të funksionojë me rregulloren e brendshme, miratuar nga Kryetari e hyrë në fuqi me datë 15.06.2009 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” duke konstatuar se nuk janë pasqyruar funksionet të cilat kanë ndryshuar më ndryshmet e ndodhura në strukturë për sa i përket funksioneve shtesë, funksionimit të tyre si dhe rregullat dhe procedurat për funksionimin e tij, pavarësisht se në pjesën kryesore e saj Rregullorja e Brendshme i plotëson funksionet.

Rekomandojmë:

Gjykata Kushtetuese të marrë masa për ndryshimin e rregullores së brendshme si dhe miratimin e Kodit të Etikës, duke reflektuar ndryshimet përkatëse si dhe duke përfshirë delegimin e detyrave, për të ndihmuar anëtarët e institucionit të kuptojnë marrëdhëniet ndërmjet strukturave administrative të veçanta, vendin që ato zënë në njësi, si dhe të njihen me të drejtat dhe detyrimet të cilat i korrespondojnë pozicioneve të tyre.

¹ Objektivi i audituesit është të formulohet një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raportit të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

² Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi.

Në vazhdimësi

3. Gjetje nga auditimi: Grupi i auditimit konstatoi se edhe pse është ngritur GMS, për vitin 2017-2018 nuk ka proces verbal të mbajtur për takimet e kryera, apo për problematikat e trajtuara në mbledhjen e GMS në kundërshtim me pikën 2.2.4 të Udhëzimit nr.16 datë 16.07.2016 “Për Përgjegjësitë dhe Detyrat e Koordinatorit të Menaxhimit Financiar.....”

Rekomandojmë:

Nëpunësi autorizues, gjatë mbledhjeve të GMS te marrë masa mbi mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve, mbi problematikat e trajtuara nga anëtarët e grupit të GMS, më qëllim dokumentimin e tyre referuar ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.

Në vazhdimësi

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R